

«Progresso» – Arsimimi në Gastronomi

Më shumë pagë falë kursit në kuzhinieri

**2**

Fate njerëzish të ikur në Zvicër

Intervistë me familjen kurde nga Siria

**3**

Një ngjarje, dy protagonistë

Kështu forcohet partneriteti social

**4**

Nr. 6 | nëntor 2015 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

**Kontrata kombëtare e ndërtimtarisë (KKN)**

## Bashkë për kushte të mira pune dhe pensionim me 60 vjet



Punëtorët e ndërtimtarisë të gatshëm dhe të vendosur që të luftojnë për të drejtat e tyre

**Këtë vit për punëtorët e ndërtimtarisë bëhet fjalë për shumëçka: Kontrata gjithëpërfshirëse Kombëtare e Ndërtimtarisë, KKP për ndërtimtarinë kryesore, përfundon në fund të vitit. Pa Kontratë në Ndërtimtarinë nuk do të kemi paga minimale, nuk do të kemi pagën e 13-të të garantuar, si dhe nuk do të kemi vazhdim të marrje korrekte së rrogës në rast sëmundjeje. Pos kësaj kemi edhe shumë probleme tjera, të cilat duhet të zgjidhen me Kontratën e re. Për një zgjidhje të mirë të këtyre problemeve, punëtorët e ndërtimtarisë janë të gatshëm të luftojnë, ashtu si tregojnë aksionet e ndryshme. Për nëntor janë planifikuar ditët e protestës.**

Kusht pune të rrezikshme dhe me ngarkesë, shtypje të pagave dhe sulm në moshën e pensionimit, nuk janë probleme vetëm të ndërtimtarisë. Gati në të gjitha profesionet shihen zhvillime të ngjashme.

**Ku mbet zgjidhja për motin e keq?**

Një problem i madh në ndërtimtarinë është mbrojtja e pamjaftueshme të punëtorëve të ndërtimit në rast të motit të keq. Presioni i afateve e terminëve në vitet e fundit është rritur shumë. Shumë shpesh punëtorëve

të ndërtimtarisë u duhet të punojnë edhe në mot të keq – në kushte të rrezikshme pune, në borë e shi – të punojnë më tej. Për çdo vit aksidentohet në punë çdo i 5-ti punëtor i ndërtimtarisë. Për këtë arsye Unia kërkon që të kemi përmirësime të qarta në Kontratën e re. Pasi, janë punëtorët e ndërtimtarisë ata që paguajnë me shëndetin e tyre.

**Ti jepet fund dumpingut në paga!**

Një problem tjetër është dumpingu në paga. Janë të nevojshme ma-

sa urgjente kundër dumpingut në paga. Mjerisht dumpingu në paga është përditshmeri nëpër kantiere dhe punës në Zvicër. Punëtorët të ndërtimtarisë ju duhet pjesërisht të punojnë për paga tejet të varfëruara. Që punëtorët në Zvicër të punojnë për pak franga është një paturpësi e madhe. Dhe kjo ka ndikim në të gjitha pagat e ndërtimtarisë. Andaj ka nevojë për masa të dukshme, që tu ndalet turri firmave joserioze të cilat ushtrojnë dumping në paga.

**Duart larg nga pensionimi me 60 vjet**

Dhe së treti, na duhet të mbrojmë pensionimin e punëtorëve të ndërtimtarisë me 60 vjet. Në vitet vijuese shumë punëtorë të ndërtimtarisë arrijnë moshën e pensionimit. Një pjesë e pronarëve të ndërtimit duan ta shfrytëzojnë këtë fakt si mburojë për të shtyrë moshën e pensionimit. Parlamenti i punëtorëve të ndërtimtarisë së Unia-s ka thënë qartas: Kjo nuk vjen në shprehje! Punëtorët e ndërtimtarisë janë të

gatshëm të luftojnë për pensionimin me 60 vjet. Nuk vjen në shprehje që punëtorët e ndërtimtarisë, të cilët me vite të tëra kanë paguar kontribute për pensionim me 60 vjet, të punojnë më gjatë. Është e vërtetë se në vitet në vijim shumë punëtorë të ndërtimtarisë do të shkojnë në pension, andaj edhe nevojiten më shumë mjete financiare në arkën e FAR-it (pensionimit të mëhershëm). Mirëpo, për këtë ka zgjidhje, fjala bie rritje e kufizuar e kontributeve. Pas pak vitesh, përsëri shkojnë më pak punëtorë të ndërtimtarisë në pension.

**Aksionet: ne luftojmë!**

Punëtorët e ndërtimtarisë janë të gatshëm të luftojnë. Këtë ata e kanë treguar në javët e fundit në regjionet e ndryshme të Zvicrës. Përmes zgjatjes së pauzave të punës në drekë dhe aksioneve simbolike, ata treguan se janë të gatshëm të luftojnë për një KKN më të mirë. Vetëm vazhdimi i thjeshtë i KKN-së për punëtorët e ndërtimtarisë nuk është zgjidhje për punëtorët e ndërtimtarisë. Nëse duhet që KKN të mbetet edhe më tej një Kontratë gjithëpërfshirëse e mirë, atëherë nevojiten zgjidhje të problemeve aktuale.

➔ Aurora Garcia

**Editorial**



«Para 13 vitesh unë qëndroja para tunelit Baregg dhe hyra në grevë për pensionimin me 60 vjet. Për këtë unë luftoj tani përsëri, nëse e lyp puna.» Këtë fjalë, shumë domethënëse, ma tha një kryepunëtor kantieri. Baraka e cila përndryshe është e zëshme u zhyt në qetësi. Secili e dinte se për çka është fjala. Në fund të vitit i kalon afati Kontratës gjithëpërfshirëse nacionale për ndërtimtarinë (LMV) dhe ajo duhet të ri-negociohet. Punëtorët e ndërtimtarisë kanë nevojë për një Kontratë të re gjithëpërfshirëse kombëtare dhe më shumë mbrojtje. Mirëpo Shoqata e ndërtimtarëve refuzon deri më tani çdo lloj zgjidhjeje dhe përcaktohet tërësisht për konflikt. Jo vetëm kjo: Kjo shoqatë atakon edhe pensionimin me 60 vjet. Sulmi në pensionim me 60 vjet është sulm në dinjitetin e punëtorëve të ndërtimtarisë. Andaj punëtorët e ndërtimtarisë në tërë Zvicrën janë në gatishmëri, për të luftuar për të drejtat e tyre.

Me këtë luftë ne jemi gjendemi në përballje, e cila është me rëndësi vendimtare për tërë Organizatën tonë. Kjo luftë e punëtorëve të ndërtimtarisë kalon kufijtë e ndërtimtarisë – ajo na prek të gjithë ne. Ndërtimtarinë me të gjitha të arriturat e saj paraqet majën së shtizës të Lëvizjes sonë: Paga minimale, orari i punës, pensionimi me 60 vjet, Kështu një Kontratë kombëtare gjithëpërfshirëse e ndërtimtarisë (LMV) është udhërrëfyese për Kontrata tjera Kolektive të Punës: Ajo që përkufizohet në LMV – më vonë merret përsipër edhe nga sektorët tjerë ekonomik. Kush qëndron i bashkuar, mund të arrijë gati gjithçka. Andaj, po për këtë arsye, punëtorët e ndërtimtarisë përmes kësaj lufte duan të jenë shembull. Ata duan të mbështeten në parimin e solidaritetit. Të mbështesim të gjithë ne punëtorët luftarak të ndërtimtarisë dhe të tregojmë edhe ne: Bashkërisht ne jemi të fortë dhe bashkërisht mund të fitojmë!

**Chris Kelley**  
Sekretar nacional i sektorit të ndërtimtarisë

**Pronarët ndërtimtarë sulmojnë pensionimin me 60 vjet. Të gjithë në ditët e protestave në nëntor, la vlen të luftosh!**



■ Duart larg nga pensionimi me 60 vjet!  
■ Stop dumpingut të pagave!  
■ Më shumë mbrojtje!

Nga **9 deri më 11 nëntor** do të protestojnë punëtorët e ndërtimtarisë bashkë me ata që solidarizohen me ta. Mesazhi është i qartë: Ne duam një KKN më të mirë dhe jo sulm në pensionimin me 60 vjet! Nga suksesi i kësaj lufte varet edhe nëse do të arrihen përmirësime në rrafshet e KKP-të të sektorëve tjerë të ekonomisë. Solidarizohuni me punëtorët e ndërtimtarisë!

News

**Unia përruron Hot-linë «shërbimi vendi i punës»**

Nga viti i ardhshëm qeveria federale dëshiron të shtendos obligimin mbi regjistrimin e kohës së punës. Grupe të caktuara të të punësuarve nuk duhet të evidentohen në të ardhmen, nëse plotësojnë kushte të caktuara. Për të këshilluar drejt punëmarrësit dhe komisione e punëtorëve dhe për të mënjeluar keqpërdorimet, Uni së fundi ka përruruar «shërbimin mbi vendin e punës». Më shumë informata mund të gjeni në faqen vijuese të internetit: [www.service-arbeitszeit.ch](http://www.service-arbeitszeit.ch)

**KKP e re për «Stadler Rail» përcakton standardet**

Unia dhe ndërmarrja «Stadler Rail» janë pajtuar për Kontratën e re Kolektive të Punës nga viti 2016. Kjo Kontratë përmban paga minimale të mira (nga 4200 franga për ndihmës punëtorë deri nga 6200 franga për teknikët) dhe mbrojtje të largimit nga puna për të punësuarit e shtyrë në moshë. Pos kësaj është arritur pajtueshmëri për masat e krizës shkaku të fuqizimit të frangut. Hiqet e drejta e zgjatjes së orarit të punës deri në 45 orë në javë, nga 1 janari 2016 vlen orari i rregulluar i punës prej 40 orëve në javë.

**Unia dëshiron KKP për transport dhe logjistikë**

Sindikata syndicom deh Unia kanë kërkuar një KKP nacionale për sektorin e transportit dhe logjistikës. Nevojitet mbrojtje më e mirë e shëndetit, paga korrekte minimale dhe rregullim të orarit të punës. Ekonomia e transportit dhe logjistikës është njëra nga sektorët me kushtet më të përkeqësuar të punës. Ditë të gjata të punës, pak pushime çlodhëse, presion terminësh, mungesa e masave të sigurisë dhe rritja e dumpingut në paga janë bërë përditshme.

**Këshilli kombëtar WAK në shërbim të tregtarëve me shumicë**

Komisioni ekonomik (WAK) i këshillit federal (parlamentit) mezi ka mbështetur propozimin e orarit të hapjes së shitoreve. Kështu kanë arritur të realizojnë qëllimet e veta tregtarët me shumicë – në kuriz të shitësve/eve, të kantoneve dhe të tregtarëve me pakicë. Ligji mbi orarin e punës së shitoreve ka për qëllim që t'ua përcaktojë të gjitha kantoneve orarin minimal të punës nga ora 6 deri në ora 20, respektivisht 6 deri 18 (të shtunave). Unia do të angazhohet që këshilli kombëtar (parlamenti federal) të mos ndjek shembullin e komisionit të tij, por atë të këshillit federal (dhoma e kantoneve) deh që në sesionin e dimrit të hedh poshtë Ligjin në fjalë.

**Reforma e përkujdesjes në pleqëri AHV/AVS**

**Jo përkeqësime të pensioneve të pleqërisë**



Pensionistët meritojnë jetë me dinjitetet në pleqëri

**Këshilli i lartë federal në sesionin e vjeshtës ka trajtuar paketën e reformës mbi AHV/AVS 2020. Përfundimi: Nuk ka fitues, por vetëm humbës.**

Në sesionin e sivjetmë të vjeshtës në shtator këshilli i lartë federal (dhoma e kantoneve) ka trajtuar propozimin e reformës të përkujdesje në pleqëri 2010. Ky këshill ka aprovuar propozimin e komisionit të vet.

**Rritje, e cila nuk qëndron**

Si përmirësim, së paku në bazë të propozimit të qeverisë federale, komisioni i këshillit të lartë federal për siguri sociale dhe shëndetësi, ka propozuar një rritje, e cila është aprovuar nga ky këshill. Është fjala për rritje në lartësinë prej 70 frangave në muaj, ndërsa për qifte deri në 226 franga. Mirëpo, nga kjo rritje do të mund të përfitojnë vetëm pensionet e ardhshme. Ata ë janë të pensionuar nuk do të përfitojnë nga rritja.

**Përkeqësimet në marshim**

Përndryshe paketa ë fjalë parashihet vetëm përkeqësime. Kështu shkalla e konvertimit do të reduktohet nga 6,8% në 6%. Për personat në pen-

sionin e detyrueshëm profesional (BVG) kjo domethënë një reduktim pensioni për 12%. Më tej parashihet të ngritet mosha e pensionimit të grave me 65 vjet. Kjo edhe përkundër disavantazhit të deritashëm me paga më të ulëta në krahasim me burrat si dhe për shkak të marrjes përsipër të detyrave shtëpiake kanë mundësi për kursime shumë më të ulëta në arkën e pensionit. Shtu kësaj edhe realitetin e pabarazisë në paga në Zvicër. Përderisa kjo është kështu, ne nuk mund të pranojmë rritjen e moshës së pensionit të pleqërisë për gra.

**AHV/AVSplus i domosdoshëm**

Paketa tani duhet të trajtohet nga parlamenti nacional, si këshilli i dytë federal. Mungesat e tanishme në dokumentin propozues duhet përmirësohen. Është më se e qartë: Kush dëshiron rritjen e të gjitha pensioneve të pleqërisë AHV/AVS dhe sigurimin afatgjatë të pakujdesjes në moshën e pleqërisë, duhet të angazhohet dhe të mbështetë iniciativën popullore të sindikatave AHV/AVS-plus, e cila do të hidhet për votim në vitin 2016.

☞ Aurora Garcia

**Sektori i kujdesit, nxënësit shëgertë**

**Nevojiten kushte më të mira në përkujdesje!**

**Në fillim të shtatorit Unia i prezantoi rezultatet e anketës me nxënësit shëgertë në sektorin e kujdesit. Nga rezultatet mund të mësojmë: Gati gjysma e të arsimuarve në sektorin e kujdesit nuk shohin perspektivë profesionale në këtë lami. Orët e tepërta të punës, paga të ulëta, tejkalim i shpeshtë i detyrave dhe kompetencave si dhe mungesa e mbështetjes janë pos tjerash pjesë të përditshmërisë të këtyre të rinjve në profesion.**

Bazuar në anketën e Unias rreth 45% e të anketuarve nuk shohin veten në këtë profesion pas 10 vitesh. «Nëse gjysma e të arsimuarve duan të lënë këtë profesion përsëri, do të përkeqësohet shumë mungesa e kadrove profesionale në këtë sektor.» Thekson Lena Frank, sekretare nacionale për rini në Unia. Pos kësaj vetëm një pakicë është e mendimit, se duhet të kujdesen ashtu si kanë mësuar dhe këtë e konsiderojnë në rregull. Si arsyt kryesore për këtë personeli i anketuar theksojnë mungesën e personelit (24%), koha e pamjaftueshme (13%) dhe kombinimi i të dyjave (12%).



të kryejnë punë jashtë kompetencave të tyre profesionale, çka paraqet rrezik sikur për personelin ashtu edhe për pacientët. Në fund 23% e të anketuarve pranojnë se gjatë aftësimit profesional nuk mbështeten mjaftueshëm dhe lihen tërësisht vetë.

**Më shumë personel – për kujdes dhe mbështetje më të mirë!**

Sindikata Unia kërkon për këtë arsye një ndryshim të qasjes në përkujdesje: Jo vetëm fitime, masa kursyese dhe numra, porse njerëzit të vihen në qendër të vëmendjes. Vetëm kështu mund të garantohet një përkujdesje e mirë dhe rritje të mjaftueshme e të qëndrueshme të personelit. Pos kësaj nevojitet mjetet të mjaftueshme financiare dhe më shumë personel profesional, më shumë kohë për përkujdesje më të mirë individual dhe mbështetje më të mirë. Gjithashtu edhe pagat më të larta, shtesa adekuate, orar korrekt të punës si dhe kontroll më të mirë të kushteve dhe të drejtës së nxënë shëgertë janë urgjentisht të nevojshme.

☞ Aurora Garcia

**«Progresso» – Arsimimi në Gastronomi**

**Më shumë pagë falë kursit në kuzhinieri**

**Kush punon si kamerier, në ekonomi shtëpiake apo edhe në kuzhinë dhe nuk posedon dëftesën e aftësimin shkollor për këtë, megjithatë mund të kualifikohet. Ia vlen.**

Në kuzhinat e restoranteve, në shërbim kamerieri apo hotele punojnë më shumë të pakualifikuar e sa në sektorët tjerë. Shpesh për një pagë të ulët dhe pak mundësi ngritjeje në profesion. Andaj ka më shumë se 10 vite që ekziston trajnim-aftësimi për të punësuarit në Gastronomi si prioritet për partnerët social të këtij sektori. Këta janë pajtuar për arsimimin bazë «Progresso» edhe me Kontratën e përgjithshme Vendore të Punës për ekonominë e Gastronomisë (L-GAV).

**Të shfrytëzohet shansi**

Arsimimi «Progresso» vlen për drejtime të ndryshme profesionale: kuzhinë, kamerier, ekonomi shtëpiake dhe ndërmarrje gastronomie që nga ato në pikat e karburanteve (pompat e benzinës) apo restorantet Takeaway. Një kurs themelor zgjat 5 javë dhe ndahet në tri blloqe.



Kursi «Progresso» mundëson kualifikimin profesional

Parakushtet për pjesëmarrje në një kurs të «Progresso»:

- Jeni duke punuar aktualisht në shërbim (kamerier), në kuzhinë, apo në ekonomi shtëpiake,
- Nuk keni kualifikim profesional në këto drejtime,
- Ju mund të komunikoni në gjermanisht, frëngjisht apo italisht,
- Ju dini shkrim-lexim.

Nëse ju dhe ndërmarrja juaj i nënshtrohet Kontratës Kolektive L-GAV, atëherë do tu merren përsipër pjesa

e madhe harxhimeve të arsimimit, të materialit shkollor, të ushqimit dhe nëse e lyp puna edhe bujtja në vendndodhjen e kursit. Pos kësaj ju merrni edhe maksimalisht 500 franga për çdo javë kurs si kompensim për zbritjen nga paga shkaku i mungesës nga puna.

**Rruga për ngritje**

«Progresso» ia vlen edhe për kuletë: paga minimale për të punësuarit me një certifikatë të tillë është 200 franga më shumë se sa të pakualifikuarit.

Ndërsa më vonë keni mundësi të bëni edhe një shkollim themelor (Attest-Lehre). Kështu hapet mundësia për shkollimin profesional me certifikatë aftësie shtetërore. Arsimimi njihet në tërë sektorin dhe në gjithë Zvicrën.

Unia ju mbështet, nëse keni ndonjë pyetje. Informatat de formularët e lajmërimit mund ti gjeni në: [www.mein-progresso.ch](http://www.mein-progresso.ch).

☞ Sina Bühler, work

**Bisedimet për kontratë l-gav janë në zhvillim e sipër**

Partnerët social (Unia, Hotel & Gastro Union, Syna, GASTROUISSE, Hotelleriesuisse dhe Swiss Catering Association) aktualisht janë duke biseduar për Kontratën e re Kolektive të Punës për sektorin e Gastronomisë. Ajo që tanimë dihet: Programi «Progresso» është i aprovuar. Informatat mbi Kontratën e vlefshme L\_GAV mund ti gjeni këtu: [www.l-gav.ch](http://www.l-gav.ch).

Drama e refugjatëve në Evropë

# Përse vijnë pikërisht tani kaq shumë refugjatë?

... dhe pyetje e përgjigje tjera mbi situatën e refugjatëve

## 1. Përse vijnë pikërisht tani kaq shumë refugjatë?

Aktualisht në gjithë botën numërohen si refugjat rreth 60 miliona njerëz. Gjysma e tyre janë fëmijë. Përditë rreth 42.500 njerëz janë të detyruar që të lënë vendin e tyre. Është numri më i lartë i refugjatëve që nga lufta e dytë botërore. Arsyet kryesore janë lufta, ndjekja dhe shkatërrimet e shteteve. Shumica e njerëzve aktualisht ikin nga lufta qytetare në Siri. Mirëpo edhe nga vendet tjera të kapluar nga kriza, si Afganistani, apo Iraku shkaktojnë valë refugjatësh.

## 2. Përse nuk u ndihmojmë në refugjatëve në vend?

Ndihma në vend është duke ndodhur. Me miliona refugjatë jetojnë në regjionet e krizës nëpër tenda. Vetëm në Somali, vendin fqinj të Eritresë kemi 1,1 milion refugjatë eritrianë. Ndërsa në vendet e krizës si Siria e Iraku, apo shtetet tjera të shkatërruara ndihma në vend gati e pamundur. Pos kësaj programet ndihmuese për refugjatë vuajnë nga financimi i pamjaftueshëm kronik. Plani ndihmues për vitin 2015 është financuar vetëm 41%. Kjo ka ndikuar trishtueshëm në shkurtime dramatike të racioneve us-



Pamje nga një manifestim solidarizues me refugjatët

hqimore dhe përkujdesjes mjekësore. Ulja e ndihmës humanitare është arsyeja kryesore e humbjes së shpresës tek refugjatët dhe vendimmarrjes së tyre për tu nisur në drejtim të Evropës.

## 3. Përse nuk punojnë azilkerkuesit në Zvicër?

Në tre muajt e parë për azilkerkuesit ekziston një ndalesë për të punuar. Pastaj mund të punojnë. Megjithatë punëdhënësi duhet të shtrojë kërkesën për këtë. Shumë nuk e dinë këtë fakt. Gjysma e refugjatëve kanë përvoja profesionale dhe me dëshirë do të fitonin vet diçka. Ish kryetarja e qeverisë federale Dreifuss kërkon, që

të eliminohen pengesat në tregun e punës për refugjatët. Ajo thotë: «Puna do të thotë dinjitet dhe pavarësi.»

## 4. Sa shumë ngarkojnë ata sigurimet tona shoqërore?

Sigurimi i pensionit të pleqërisë dhe trashëgimtarëve AHV/AVS si dhe ai i të papunëve nuk preket nga vala e refugjatëve. Pasi në fillim refugjatët nuk kanë të drejtë përfitimi. Ato krijohen tek kur ta punojnë dhe paguajnë kontribute. Me rëndësi për ta ditur: Punëmarrësit me sfond migracioni paguajnë në Zvicër më shumë kontribute në arkat e sigurimeve shoqërore se sa marrin përfitime to.

⇒ Ralph Hug, work

## Zgjedhjet për parlamentin zviceran 2015

# Zgjedhjet parlamentare në Zvicër: Ngadhënjimi i frikës



Më 18 tetor qytetarët votues zviceran kanë zgjedhur Parlamentin e ri zviceran. Fituese është parasëgjithash Partia Popullore e Zvicrës (SVP), mirëpo edhe Partia Liberale (FDP) arriti të fuqizohet. Partia Socialdemokrate (SP) mundi të mbetet deri diku, ndërsa të Gjellërit humbën vota elektorati. Në përgjithësi ne gjendemi qartas para një rrëshqitjeje djathtas. Për politikën e sociale dhe atë të migracionit e ardhmja do të jetë e zymtë.

Parashikimet kanë treguar se SVP do të rritet me elektorat. Ato janë vërtetuar. SVP fitoi 3% më shumë vota, ashtu edhe FDP borgjeze, të cilat në çështjen e migracionit kanë politizuar djathtas. Të gjitha partitë tjera, me përjashtim të SP, në këto zgjedhje parlamentare kanë humbur. SP ka mundur me mobilizim të mirë të mbajë elektoratin e vet.

## Si do të ecën më tutje?

Këshilltarët e ri nacional janë të njohur: pikërisht tek partitë e majta disa nuk janë zgjedhur më. Të tjerët janë vërtetuar, si fjala bie anëtari i drejtorisë qendrore të Unia-s Corrado Pardini. Tek këshilli federal (dhoma e kantoneve) vendet ende nuk janë kristalizuar. Shumë kandidat duhet ti nënshtrohen rëndit të dytë zgjedhore, si fjala bie kandidati nga St. Galleni, Paul Rechsteiner. Kjo do të vendoset kah mesi i muajit nëntor.

## Qeveritari i dytë federal për SVP?

Më 9 dhjetor mbahen rizgjedhja e përgjithshme e qeverisë federale. Pyetja që shtrohet me këtë rast është se a do ti takoj edhe një ulësë në kabinetin e qeverisë federale SVP-së. E ashtuquajtura formulë magjike thotë se tri partive më të mëdha u takojnë nga dy ulësë. Kjo formulë magjike ekziston që 50 vite dhe ajo shërben për të siguruar baraspeshën në qeverinë federale. Andaj SVP-ja do të ngul këmbë në ulësën e dytë. Është e qartë, politika zvicerane do të bëhet më jo sociale.

⇒ Aurora García

## Intervistë



Bashkëshortët refugjat kurd, Hamid e Hiyam Khalid

## Histori refugjatësh

# Intervistë me familjen refugjate nga Siria

Mes shumë refugjatësh të ikur nga Siria është edhe familja Khalid, me përkatësi kurdë. Zotëriu Hamid dhe bashkëshortja e tij, zonja Hiyam Khalid kanë kaluar të 50-at. Familja Khalid ka tre fëmijë në moshën 17, 24 dhe 27 vjeç, dhe jetojnë që nga dhjetori 2013 në Zvicër. Ata posedojnë lejen humanitare e përkohshme humanitare të qëndrimit F.

Para luftës siç thotë z. Khalid kanë jetuar të krishterët, myslimanët, kurdët, arabët dhe të gjithë njerëzit tjerë bashkë pa probleme me veti. Për ju lexues të dashur Horizonte ka zhvilluar një bisedë me këtë çift refugjatësh kurdë në Zvicër, të cilën mund ta lexoni në vijim:

## Z. Khalid, përse keni ikur jashtë vendit tuaj?

**Hamid Khalid:** Ne kemi jetuar 35 vjet në Damask. Damasku përpara ishte një qytet i qetë dhe ne ishim të kënaqur me jetën tonë. Unë punoja si punëtorë ndërtimtarie, fitoja mirë dhe kishim një banesë, deri në kohën kur filloi përleshja mes regjimit të Asadit dhe Ushtria e lirë e Sirisë. Kjo ushtri arriti të marrë Damaskun pas tërheqjes së ushtarëve të Asadit. Pastaj filloi terrorizimi i popullatës që jetonte në afërsi të konfliktit. Ata kontrolluan banesën tonë dhe gjatë kontrollit shkatërruan gjithçka. Kjo na bëri që të kemi frikë edhe për jetën e fëmijëve tanë. Andaj i dërguam ata në Afrin (regjion i banuar me shumicë kurdë në Siri). Pastaj shkoi edhe gruaja ime atje. Unë fillimisht mbeta vetëm në Damask pas kësaj peledhjeje k. Një ditë erdhi deri te luftime të ashpra mes ushtrisë së Asadit dhe Armatës së Lirë Siriane. Pas kësaj përleshjeje rreth 5000 ushtarë të regjimit të Asadit kanë filluar të shkatërronjë të gjitha shtëpitë e banesat në regjion, pastaj kanë arrestuar me qindra njerëz, duke menduar se ata janë duke mbështetur Armatën e Lirë Siriane. Atë natë jam fshehur tek axha im. Të nesërmit në mëngjes kur shkova në shtëpi, pash se banesa ishte grabitur. Mbylla derën e banesës dhe së pari shkova për në Zarova dhe nga aty me automobilin tim për në Afrin ku kisha dhe familjen time. Edhe aty situata për ne nuk ishte e sigurtë, kështu që u larguam jashtë vndit.

## Zonja Khalid, ju është dashur ta leni burrin tuaj në Damask dhe bashkë me fëmijët tuaj të shkoni në Afrin. Si ishte kjo për ju?

**Hamid Khalid:** Jeta ishte e vështirë. Isha bashë me fëmijë e mijë dhe kjo ishte e vetmja gjë e mirë. Shpëtimi i fëmijëve tanë ishte kryesorja. Mirëpo gjatë gjithë kohës kam menduar për burrin tim. Ai kishte mbetur në një vend të rrezikshëm. Ne e kemi thirrur rregullisht për të mësuar se ishte mirë. Për fatin tonë ne kishim një banesë edhe në Afrin, ku jetonin edhe të afërmit tonë.

## Përse keni ardhur në Zvicër?

**Hamid Khalid:** Së pari kemi ikur për në Turqi, në Ankara. Pastaj kemi ardhur në Zvicër. Ne kemi të afërmit tanë që jetojnë në Zvicër, ata na janë ftuar dhe qeveria e Zvicrës na i ka dhënë vizat.

## Cili është dallimi mes jetës suaj në Damask dhe këtu në Zvicër?

**Hamid Khalid:** Në Zvicër ndihemi të sigurt, nuk ka luftë, jeta jonë nuk është e rrezikuar. Për mbështetjen dhe ndihmën e falënderojmë Zvicrën. Ne kemi edhe vështirësi. Financiarisht ishim shumë më mirë në Damask se sa këtu. Uni ftoja 6000 dollar në muaj, kishim një banesë në Damask dhe një në Afrin. Jeta ishte tepër e lirë dhe kishte mjaft punë. Këtu nuk mund të punoj. Marrë vetëm 380.– me të cilat duhet të jetojë. Edhe jeta e përditshme nuk është thjeshtë. Ka shumë rregulla dhe nuk ka njerëz me të cilët ne mund të bisedojmë. Si familje ne dum të mësojmë gjermanisht, duke vizituar kurset e gjermanishtes. Unë si kurdë në Damask është dashur te mësoj edhe arabishten, ndërsa këtu duhet të mësoj gjermanishten. Unë ëndërroj nga ajo që lufta në Siri të përfundoj dhe që regjioni kurd Rojava të gëzojë njohje dhe që ne pastaj të mund të kthehemi në vendin tonë.

⇒ Emine Sariaslan

Një ngjarje, dy protagonistë

# Kontribut i përbashkët për forcimin e partneritetit social

Dy profile të ndryshme e prezantojnë punën e tyre: Një ndërmarrës ndërtimtarie dhe një sekretar sindikal. Sfondi dhe motivacioni i tyre janë një histori suksesi dhe angazhimi social.

Rreth 40 burra, 5 gra dhe drejtori i tyre i mbajnë veshët. Sekretari sindikal Samet Lazami ua prezanton punëtorëve të firmës së ndërtimtarisë Berzati AG sindikatën e punëtorëve Unia. Ai flet për të drejtën në punë dhe atë të sigurimeve sociale, për pagën minimale dhe për atë të 13-tën, për kontratën kolektive në sektorin e ndërtimtarisë dhe për gjithë repertorin e sindikatës – në ambientet e reja të Berzati AG në Reinach të Aargaut.

## Kundërshtarët që janë partnerë

«Kjo nuk është edhe aq e vetëkuptueshme», e pranon Lazami. Një rast të tillë ai nuk e ka çdo ditë, ai i jepet nja pesë herë në vit. Sekretari është i bindur nga puna që bën, sepse sindikata i përfaqëson interesat e punëtorëve. Lazami i informon të pranishmit për të drejtat dhe obligimet e një marrëdhënieje pune dhe përparësitë e anëtarësisë në sindikatë. «Së bashku jemi më të fortë dhe mund t'i përmirësojmë kushtet e punës në sektorin e ndërtimtarisë», thotë Lazami. Unia u ofron punëtorëve këshillim dhe përfaqësim juridik në lidhje me çështje të së drejtës së punës dhe asaj të sigurimeve sociale, deri në plotësimin e dokumentacionit të tatimit për gjithë familjen për një çmim real. Sidomos ndërtimtarisë është një fushë ku mund të dilet me 60 vjet në pension, përkujton Lazami – një proces ky që kërkon përcjellje. «Por, punëdhënësit dhe sindikatat nuk janë kundërshtarë të lindur», siguron ai. Ata e quajnë njëri-tjetrin partnerë socialë. Ndërmjet tyre ka një kontratë kolektive, e cila skadon në fund të 2015-tës dhe duhet të rinovohet. Ajo i rregullon kushtet e punës për rreth 10000 punëtorë të ndërtimtarisë; pa këtë marrëveshje, e cila quhet «Lndesmantelvertrag», nuk do të kishte pagë minimale dhe mbrojtje nga ulja e rrogave. Kërkesa kryesore e sindikatës tani është e drejta për ndërprerjen e punës në rast të motit të lig dhe ruajtja e moshës së pensionit me 60 vjet. «Në çështjen e pensionimit të hershëm nuk guxon të ketë lëvizje», thekson Lazami.

Për drejtorin Muharem Berzati, këto gjëra nuk janë të panjohura. Ai momentalisht i angazhon mbi 30 punëtorë. Disa prej tyre janë prej kohësh anëtarë të sindikatës, dhe kjo atij nuk i pengon fare. Berzati ka kërkesa të qarta për punëtorët dhe u paguan atyre rroga fer. Ai nuk flet me



Tubim i përbashkët: sindikalist, ndërmarrës e punëmarrës shqiptar

kënaqësi për aktivitetet e tij bamirëse dhe ndjek moton: Bëj mirë, e qëndro modest!

## Dëshmitarë të suksesit

Përderisa punëtorët e ndjekin me vëmendje ligjëratën e sekretarit sindikal, Berzati tanimë e ka ndezur furën elektrike për festën që i pret në mbarim. Shefi, dora vetë, i shërben punëtorët e tij me specialitete të shijshme nga skara. Ai ka marrë përsipër ta përgatisë gjellën kryesore dhe t'u japë komplimente muntorëve, për shtesën e sallatës kujdesen gratë nga administrata e firmës.

Yasemin Cakmak, 30 vjeçe dhe zëvendës drejtoreshë, është aty që nga themelimi i ndërmarrjes gjenerale Berzati AG. Ajo e ka përjetuar gjithë rritjen e ndërmarrjes dhe është krenare për kontributin e saj. Cakmak është kompetente për zhvillimin e projekteve në fazën e planifikimit. Për të, prezantimi i sekretarit sindikal është i mirëseardhur. «Edhe unë si punëmarrëse përfitoj sot nga kjo ligjëratë interesante», pohon ajo.

Agim Latifi, 55 vjeç, është ndër punëtorët më të vjetër i Berzati AG. Ai punon në vinç dhe e sheh për çdo ditë se si ngrihen nga zeroja objektet e firmës ku punon. Mësuesi i edukatës fizike nga Kosova të Muharem Berzati nuk e ka gjetur vetëm një punëdhënë, por edhe respektin njerëzor. Mbrëmje të tilla skare me punëtorë, rrëfen Latifi, firma organizon disa herë në vit. Ndërsa ligjëratën e Lazami të gjen si shumë informative.

## Angazhim i flaktë shoqëror

Samet Lazami erdhi në vitin 1984 te babai i tij në Zvicër, i cili jetonte në Luzern nga viti 1963. Shqiptari nga Maqedonia i ndërpreu studimet e frëngjishtes në Prishtinë për t'ia kursyer vetes një karrierë stinori në Zvicër. Ëndrrën si gazetar u desh ta braktiste për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike në vendlindje. Një jetë në mirëqenie, më shumë siguri dhe shanse për avancim profesional e shpuri atë në sektorin e ndërtimit në Zvicër. Për 24 vjet, Lazami i për-

shkoi të gjitha shkallët e karrierës që mund t'i kalonte aty. Raportin e tij me njerëzit e karakterizon një respekt i thellë.

Samet Lazami ka qenë gjithmonë politikisht aktiv dhe është angazhuar për një jetë në solidaritet dhe të drejtë. Ai qëndron për familjen e tij dhe integritimin e saj në shoqërinë zvicerane. Përvojën e fituar dhe bashkëpunimin me sindikatën në sektorin e ndërtimit, Lazami dëshironte ta përjetonte dhe ta zbatonte në një tjetër mënyrë. Kërkimi i një veprimtarie me orientim social dhe pjesëmarrje aktive e ka shpënë atë te Unia për Zvicrën qendrore.

Aty Lazami mund ta shpaloste personalitetin e tij. Ai këtu e sjell nervin e tij social dhe njohjen specifike për rrethanat në sektorin e ndërtimit. Prej gjashtë vjetësh, Lazami i sqaron punëtorët për të drejtat e tyre dhe i bën ato për sindikatën. Ai i përcjell në mënyrë kompetente 1'500 anëtarë sindikalë. Shumica prej tyre shqiptarë. Lazami e udhëheq sekretariatit në Sursee, ku çdo të mërkurë ai është në dispozicion të anëtarëve nga rrethina e tij. Në këtë kuadër, sindikalisti edhe përkthen nga gjermanishtja në shqip, dhe anasjelltas. Shumë shpejt, i certifikuar për këtë gjë. «Kur me angazhimin tim mund ta përmirësoj cilësinë e jetës së punëtorëve, jam shumë i lumtur. Atëherë e di që përpjekja ime i ka lëvizur gjërat pozitivisht», nënvizon Samet Lazami.

## Sekreti i suksesit

Muharem Berzati është 37 vjeç dhe jeton që prej 23 vjetësh në Zvicër. Ai ka ardhur këtu në kuadër të një bashkimi familjar, si pesëmbëdhjetëvjeçar. Në firmën ku punonte babai i tij, Berzati mund ta kryente një zanafillë si murator. Më pas e ndoqi një shkollë nate për kryepunëtor, ndërsa më vonë në Sursee e kreu kualifikimin për udhëheqës ndërtimi.

Berzati vazhdoi në zyrën e një ndërmarrjeje ndërtimi. Shkurt më pas, në vitin 2003, ai e themeloi ndërmarrjen e tij. Pas blerjes që u bën dy firmave të tjera, ai në vitin 2009 e themelon ndërmarrjen gjenerale Berzati AG. Që këtu firma e ka zgjeruar aktivitetin në shumë fusha.

«Filozofia ime themelore është zbatim i vizioneve të mia për një ndërtim profesional nga fillimi deri në brendi dhe arritja e një optimumi të funksionalitetit dhe estetikës», sqaron Muharem Berzati, dhe vazhdon: «Konceptet tona kryesore i arrijmë nëpërmjet komunikimit të hapur me klientët, furnizuesit dhe të interesuarit». Motoja e tij është: «Ne e gjejmë gjithmonë një rrugë, e kur nuk e gjejmë – atëherë e ndërtojmë vetë atë».

© Kujtim Shabani, dialogplus.ch

## Ju pyesni, Unia përgjigjet



### Vendet e caktuara të punës: A duhet ti pranojë unë?

Unë kam punuar si punonjës kontabilist tek një agjenci sigurimesh, mirëpo ka nja tre muaj që jam i papunë. Tani këshilltari i në entin regional për ndërmjetësim të punës më ka caktuar një punë si pastruese. Mirëpo unë nuk dua të një këtë punë. Por këshilltari thotë se unë duhet të kryejë këtë punë, pasi tani jam vetëm 24 vjeç. Vetëm nga moshë 30 vjeç mund të ngulet këmbë për vend punë në profesionin e vet. Si pastruese unë fitoj më pak se sa shuma kompozuese e parave ditore që unë marrë nga arka e papunësisë. Kjo nuk është në rregull, apo jo?!

Po, kjo është e mundur. Me rastin e revizionit të ligjit për të papunët në vitin 2011 janë rënduar kushtet për të siguruarit nën moshën 30 vjeç. Andaj aktualisht kjo vlen edhe për ju: Përderisa, 1. paga për punën e kryer është në rregull, 2. nuk është fjala për punë të pacaktuar e të kohëpaskohshme, dhe 3. udhëtimi për në vend të punës nuk zgjat më shumë se dy orë, ju duhet të pranoni vendin e caktuar të punës, edhe nëse ai vend pune nuk i përgjigjet kualifikimit dhe aftësitë tuaj arsimor. Mund të ndodh në raste të rralla, mirëpo enti në fjalë ka të drejtë për të caktuar vendin e punës.

Edhe nëse paga për pastruese është më e ulët se sa paga e juaja ditore e kompensuar nga arka e papunësisë: në fund të fundit edhe ashtu do keni më shumë para në dispozicion se sa tani. Pasi që arka e papunësisë juve do tua llogarit punën si pastruese si punë të përkohshme dhe ju megjithatë do të merrni kompensimin shtesë. Të ardhurat nga puna e përkohshme plus kompensim-pagesa e arkës së papunësisë të llogaritura bashkë është më e lartë se sa vetëm paratë e papunësisë.

Michael Schweitzer, work, 3.9.2015

### 10-orë pune-në ditë: A lejohet që të punojnë aq gjatë të rinjtë?

Unë jam 17 vjeçar dhe jam në arsimim shqetësi si shitës në një shitore veshmbathjesh. Mua më pëlqen puna e edhe shefja e kolegët janë të sjellshëm. Mirëpo, të enjteve tek ne është shitja në mbrëmje deri në ora 21. Kështu unë punoj të enjteve 10 orë, dhe atë nga ora 8-12 dhe pastaj nga ora 15 deri në 21. Kjo është mjaft rigorozë. Pos kësaj unë duhet të udhëtoj gjatë dhe kam lidhje të këqija komunikacioni për në vend të punës. Kështu edhe përkundër pauzës së gjatë të drekës unë nuk kam mundësi të shkojë ne shtëpi për pushimin e drekës. A është e lejuar me ligj një ditë e tillë pune?

Jo. Pasi për punëmarrësit rinj (pra për personat deri në mbushjen e moshës 18 vjeç) vlejën rregulla të veçanta mbrojtëse: Koha e punës ditore mund të zgjas më së shumti 9 orë (neni 31 i Ligjit të Punës). Ky orar maksimal i punës vlen në të gjitha rastet dhe pa asnjë përjashtim, pra edhe atëherë kur duhet kryer punë emergjente apo edhe kur papritur duhet kryer më shumë punë.

Vendi juaj i aftësimi profesional bënë edhe një shkelje tjetër të rregullave ligjore: Tek të rinjtë orari i punës ditore duhet të jetë kryhet brenda një afati kohor 12 orësh: pra nëse ju filloni punën të enjteve në ora 8, orari i punës ditore tuaj duhet të përfundojë më së voni në ora 21. Ju duhet gjithsesi të bisedoni me shefen tuaj për t'iu përmbajtur ajo pa zvarritje rregullave të kohës së punës edhe në ditët e shitjeve të enjteve mbrëmë.

Peter Schmid, work, 1.10.2015



Sindikalisti Samet Lazami & Ndërmarrësi Muharem Berzati

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber work, Gewerkschaft Unia, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Social SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. García, A. Rogalewski, D. Filipovic, E. Sarlaslan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck NZZ Print, Zürcherstrasse 39, 8952 Schlieren | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft.  
Le Syndicat.  
Il Sindacato.

www.unia.ch